REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS · OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS · DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.Ikaj/Br.stt. 779
Data/Datum. 08.05.2026
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS · OPŠTINA KOSOVO POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

Fushë Kosova

KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

**Datë: 08.05.2026**

Komuna e Fushë-Kosovës, bazuar në nenin 68, paragrafi 3, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 17, paragrafi 1, nën - paragrafi 1.2, nenin 19, nenin 21, nenin 22, paragrafi 1, nën - paragrafi 1.3, nenin 28, të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, nenin 88, të Statutit të Komunës së Fushë-Kosovës Nr. 98, të datës 17.08.2012, vendimin e Kuvendit të Komunës Nr. 113, të datës 25.03.2026, shpallë këtë:

## NJOFTIM
## Për konsultim publik për Projekt-Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2026-2028 në Komunën e Fushë-Kosovës

Njoftimi për diskutimin publik lidhur me 'Projekt-Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2026-2028 në Komunën e Fushë-Kosovës', është i hapur nga data: **08.05.2026 deri më datën 22.05.2026.**

Projekt-Planin Lokal i Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2026-2028 në Komunën e Fushë-Kosovës, është i publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës së Fushë Kosovës

Komentet, sugjerimet apo vërejtjet lidhur me dokumentin, mund t'i adresoni permes adresave elektronike si vijon: lindita.dervisholli@rks-gov.net dhe hasan.gjyrevci@rks-gov.net.

Komuna e Fushë-Kosovës e ka paraparë edhe një takim fizik në kuadër të këtij Konsultimi Publik, i cili do të mbahet me datën: **18.05.2026, me fillim prej orës 10:00h** në Sallën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovë.

**Me respekt,**

**Kryetari i Komunës**
**Valon Prebreza**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.faq/Br.str. 113
Data/Datum 25.03.2026
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**
**REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË–KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE**
**MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**

---

**Datë: 24.03.2026**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 18.03.2026, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 252, të datës 06.03.2026, të paraqitur për shqyrtim nga Koordinatorja e Njësitit për të Drejtat e Njeriut dhe Zyrës për Barazi Gjinore, i shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr.28/2008), nenin 5, paragrafi 1, paragrafi 2, të Ligjit për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020, (Gazeta Zyrtare Nr. 16/2015), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës së Fushë-Kosovës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

# V E N D I M

## Për aprovimin në parim për diskutim publik të Projekt-Planit të Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2026-2028 në Komunën e Fushë-Kosovës

1. Për aprovimin në parim për kalimin në procedurën e diskutimit publik të 'Projekt-Planit të Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2026-2028 në Komunën e Fushë-Kosovës'.

2. Projekt-Plani i Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2026-2028 në Komunën e Fushë Kosovës, i cekur në paragrafin 1 të këtij vendimi, parasheh zbatimin nga institucionet komunale të programeve, punëve dhe aktiviteteve për barazi gjinore.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është 'Projekt-Plani i Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2026-2028 në Komunën e Fushë-Kosovës.

4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe mbajtjen e diskutimit publik, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Njësitit për të Drejtat e Njeriut dhe Zyrës për Barazi Gjinore.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Njësitit për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**
**Vlonjat Hasani**

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS * SKUPŠTINA OPŠTINA KOSOVO POLJE
FUSHË-KOSOVË KOSOVO POLJE

252

06.03.2026

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË , KOSOVO POLJE

| | |
|---|---|
| PËR (ZA) TO: | Z. Vlonjat Hasani Kryesuse i Kuvendit<br>Komitetit për Politikë dhe Financa<br>Komitetit për Komunitete<br>Kuvendit |
| PËRMES(PREKO)THROUCH | Z.Valon Prebreza Kryetar i Komunës |
| NGA (OD) FROM: | Znj.Lindita Dervisholli Prebreza Udhëheqëse e Sektorit për të Drejtat e Njeriut Barazi Gjinore |
| LËNDA/PREDMET/ SUBJECT: | Plani lokal i Veprimit për Barazi Gjinore 2026 -2028 |
| DATA/DATUM/DATE: | 06.03.2026 |

Të nderuar/a

Hartimi i Planit të Veprimit për arritjen e barazisë gjinore në Komunën e Fushë-Kosovës është obligim që rrjedh nga Ligji për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020, konkretisht nga Neni 5, paragrafi 1.2, i cili obligon institucionet e Republikës së Kosovës të miratojnë strategji dhe plane veprimi për promovimin dhe avancimin e barazisë gjinore.

Propozoj aprovimin e Planit të Veprimit për Barazi Gjinore, i cili përmes aktiviteteve të planifikuara do të kontribuojë në promovimin e barazisë gjinore dhe në përmirësimin e performancës komunale.

Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA /REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË -KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE

# Plani i Veprimit për Barazi Gjinore 2026 -2028

Fushë Kosovë

## Përmbajtja

Hyrje përmbledhëse

Qëllimi dhe objektivat e planit të veprimit

Korniza ligjore dhe institucionale

Metodologjia
Parimet kryesore
Aktivitetet për zbatim

Tabela e veprimeve

## I Hyrje përmbledhëse

Barazia gjinore është një e drejtë themelore e përcaktuar si një parim fondamental në Kushtetutën e Republikës së Kosovës ,barazia gjinore konsiderohet faktorë i rëndësishëm për rritje dhe zhvillim ekonomik, mirëqenje sociale dhe stabilitet.

Arritja e barazisë gjinore e paraparë edhe me Ligjin për Barazi Gjinore nr 05/L-020 kërkon angazhim të strukturave të ndryshme publike dhe private për të diskutuar dhe zgjidhur çështjet e ndryshme si ato të arsimit ,shëndetit ,shërbimeve sociale punësimit, drejtësisë ,familjes, fëmijëve dhe të moshuarve etj.

Me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të diskriminimit gjinor dhe arritjes së barazisë gjinore, institucionet e Republikës së Kosovës të të gjitha nivele të pushtetit ligjëvënës ekzekutiv gjyqësor dhe institucionet e tjera publike janë përgjegjësëe për të zbatuar masat legjislative si dhe masat tjera duke përfëshirë edhe miratimin e strategjive dhe planeve të veprimit për promovimin dhe vendosjen e barazisë gjinore në përputhje me Programin e Kosovës për Barazi Gjinore.

Komuna e Fushë Kosovës si dhe komunat tjera kanë detyrim në zbatimin e këtij programi, prandaj është edhe detyrim që të kenë plane të veprimit në të cilat do të specifikojnë aktivitetet me qëllim të realizimit të objektivave qendrore.

Ky plan veprimi i referohet implementimit si dhe zbatimit të kuadrit ligjor për barazi gjinore në tërsi si dhe akteve tjera nënligjore dhe politikave publike për barazi gjinore .

Barazia gjinore nënkupton që qeniet njerëzore, gratë dhe burrat, janë të lirë t'i zhvillojnë aftësitë e tyre personale dhe të bëjnë zgjedhje pa pasur kufizime të vëna nga stereotipet gjinore, rolet e ngurta gjinore, apo paragjykimet. Barazi gjinore do të thotë që sjelljet, aspiratat dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave merren parasysh, vlerësohen dhe favorizohen në mënyrë të barabartë. Barazi gjinore nuk do të thotë që gratë dhe burrat duhet të bëhen të njëjtë, por që të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre nuk do të varen nga fakti nëse kanë lindur femra apo meshkuj.

Drejtësia gjinore nënkupton që gratë dhe burrat trajtohen në mënyrë të drejtë, sipas nevojave të tyre përkatëse. Kjo mund të përfshijë trajtim të barabartë, ose trajtim që është i ndryshëm, por që konsiderohet i barasvlershëm për sa i përket të drejtave, përfitimeve, detyrimeve dhe mundësive. Në kontekstin e zhvillimit, synimet për drejtësi gjinore shpesh kërkojnë përfshirjen e masave që kompensojnë për disavantazhet historike dhe sociale të grave.

## II Qëllimi dhe objektivat e planit të veprimit

Plani i Veprimit Trevjeçar për Barazi Gjinore 2026 – 2028 synon promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave ,të rejave dhe vajzave,duke integruar përspektivën gjinore në të gjitha politikat dhe programet lokale në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dokumentet strategjike kombëtare.

Qëllimi kryesor i planit është rritja e vetëdijesimit dhe avancimi i të drejtave të barabarta për gra dhe burra,vajza dhe djem,në të gjitha fushat e jetës shoqërore,ekonomike dhe institucionale,duke adresuar në mënyrë të veçantë grupet e cenueshme dhe duke marrë parasyshe diversitetin gjinor.

## III. Korniza ligjore dhe institucionale.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përcakton konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, sikurse "Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave" (njohur si CEDAW), "Rezoluta 1325 e Kombeve të Bashkuara mbi gratë, paqen dhe sigurinë", apo "Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën e dhunës ndaj grave e dhunës në familje" (e njohur si "Konventa e Stambollit"), drejtpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin vendor dhe në rast konflikti konsiderohet që këto konventa kanë prioritet ndaj akteve dhe ligjeve të nxjerra nga institucionet publike.

"Ligji për vetëqeverisje lokale", themelon bazën ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës.

"Ligji për barazi gjinore", garanton, mbron dhe promovon barazinë midis gjinive, si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë.

Programi i Kosovës për barazi gjinore synon të sigurojë që barazia gjinore është në qendër të proceseve transformuese në Kosovë, në kuadër të të gjitha strukturave, institucioneve, politikave, procedurave, praktikave dhe programeve të qeverisë, agjencive, shoqërisë civile, sektorit privat dhe komunitetit të donatorëve.

Plani lokal i veprimit për barazinë gjinore 2026 - 2028 i Komunës së Fushë – Kosovës mbështetet në një tërësi dokumentesh të rëndësishme ligjore dhe institucionale, të cilët udhëheqin njëkohësisht edhe veprimet mbarëkombëtare për fuqizimin e gruas dhe përparimin drejt barazisë gjinore në Kosovë. Si më kryesoret mund të përmendim:

1. **Instrumentet kryesore ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave:**
   - "Deklarata universale për të drejtat e njeriut
   - "Konventa evropiane për të drejtat e njeriut
   - "Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike
   - "Konventa ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore
   - "Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW)
   - "Konventa e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijës
   - "Deklarata dhe Platforma për veprim e Pekinit
   - "Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje
   - "Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi gratë, paqen dhe sigurinë
   - "Agjenda e Kombeve të Bashkuara për zhvilli Direktiva (BE) 2019/1158 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 20 qershor 2019 mbi balancën punë-jetë për prindërit dhe kujdestarët
   - Direktiva (BE) 2024/1385 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 14 maj 2024 për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje
   - "Karta Evropiane për barazi të grave dhe burrave në jetën lokale etj.

2. **Korniza ligjore dhe zhvillimore kombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave:**
   - "Kushtetuta e Republikës së Kosovës", neni 7, 21 dhe 22
   - "Ligji për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040
   - "Ligji për barazi gjinore, nr. 05/L-020
   - "Ligji për trashëgiminë në Kosovë nr.2004/26
   - "Ligji nr. 06/L-077, për ndryshim- plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për familjen i Kosovës"
   - "Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, nr.05/L-021
   - "Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, nr. 03/L-154
   - "Ligji i punës, nr. 03/L-212
   - "Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, nr. 08/L-185
   - "Ligji nr. 08/L-255 për shërbime sociale dhe familjare

- "Ligji nr. 04/l-096 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë
- "Ligji nr. 03/L022, për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuar të
- përhershme
- "Ligji nr. 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit
- "Ligji nr. 06/L-084, për mbrojtjen e fëmijës
- "Ligji nr. 04/L-125, për shëndetësi
- "Ligji nr. 06/L-026, për azil
- "Ligji nr. 03/l-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit
- "Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024
- "Strategjia kombëtare për zhvillim - 2030
- "Programi për reforma në ekonomi (PRE) 2022 - 2024
- "Strategjia e barazisë gjinore e Bashkimit Evropian dhe "Plani i veprimit për barazinë gjinore (GAP III)

**Hartimi i Planit të veprimit për arritjen e barazisë gjinore të Komunës së Fushë - Kosovës është obligim që del nga Ligji** për Barazi Gjinore 05/L -020 specifikisht, Neni 5 , paragrafi 1.2 i cili obligon institucionet e Republikës së Kosovës të miratojnë strategji dhe plane të veprimit për promovimin dhe vendosjen e barazisë gjinore.

Për më tepër ky ligj në paragrafin 1.3 obligon institucionet të përfshijnë integrimin gjinor në të gjitha politikat, dokumentet dhe legjislacion , sigurimin e barazisë gjinore në proceset e përzgjedhjes dhe caktimit në punë duke përfshirë pozicionet drejtuese duke siguruar përfaqësim të barabartë edhe në konferenca mbledhje dhe trajnime dhe duke siguruar burime të përshtatshme njerëzore dhe financiare për programe,projekte dhe iniciativa per arritjen e barazise gjinore

Ligji gjithashtu obligon institucionet edhe për mbledhjen e të dhënave sipas gjinisë dhe shpërndarjen e tyre

Institucionet publike ndërmarrin masa të vecanta të përkohshme me qëllim të arritjes dhe realizimit të barazisë faktike midis femrave dhe meshkujve në fushat ku ekzistojnë pabarazi .

Ky Plan veprimi është hartuar duke konsideruar instrumentet, kornizën ligjore dhe politikat kryesore ndërkombëtare dhe kombëtare për sigurimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin ekonomik të grave.

## Metodologjia

Ky plan veprimi është hartuar nën udhëheqjen e Sektorit për të Drejtat e Njeriut Barazi Gjinore, në bashkëpunim me grupin punues me Vendim Nr.1345.
Grupi punues përbëhet nga përfaqësues të të gjitha institucioneve relevante, të cilët kontribojnë në hartimin dhe zbatimin e këtij plani të veprimit.

Parimet kryesore të cilat janë marrë parasysh në hartimin e këtij plani janë:

- ✓ Të drejtat e grave janë dhe të drejtat e njeriut,
- ✓ Barazia gjinore është kontribuues i rëndësishëm për zhvillim të qëndrueshëm të vendit,
- ✓ Komuna duhet të posedojnë kapacitete për të integruar barazinë gjinore dhe avancuar fuqizimin e grave,
- ✓ Komuna duhet të përfshijë integrimin gjinor në politikat e saj
- ✓ Komuna duhet të merr parasysh nevojat e grave dhe sidomos grave te komuniteteve tjera
- ✓

PLANI I VEPRIMIT: 2026-- 2028

| I. | Objektivi Strategjik: PROMOVIMI I BARAZISË GJINORE DHE FUQIZIMI I GRAVE TË REJA DHE VAJZAVE, DUKE MARRË PARASYSH NEVOJAT DHE RRETHANAT E NDRYSHME TË TYRE.<br><br>1.Objektivi specifik: *Rritja e vetëdijesimit të grave dhe avancimi i të drejtave dhe mundësive të barabarta për gra dhe burra në nivel lokal.* | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Buxheti | | | | | | |
| | Veprimi/Aktiviteti | Afati i fundit | Viti 2026 | Viti 2027 | Viti 2028 | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Produkti rezultati | Referenca në dokumente |
| 1.1 | Thirrje publike për financimin e OSHC- ve në fushën e barazisë gjinore.<br>Sipas objektivave të Planit të | 2026-2028 | 10,000 | 20,000 | 20,000 | Buxheti Komunal | Drejtoria e Administrates.<br><br>Sektori për të Drejtat e Njeriut Barazi Gjinore | Projektete e realizuara.<br><br>6 deri 8 organizata përfituese. | Rregullore MF- NR – 04/2017 PKBGJ dhe Ligji per barazi gjinore |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Veprimit për Barazi Gjinore 2026- 2028. | | | | | | | | |
| 1.2 | Aktivitete vetëdijesuese në kuadër të Javës së Barazisë Gjinore (7 – 8 Mars) | 2026 -2028 | 500 | 500 | 1000 | Buxheti komunal, donatoret | Sektori për Drejtate njeriut Barazi Gjinore Drejtoria e Arsimit OJQ | 4 deri 5 aktivitete të realizuara. | PKBGJ dhe Ligji per barazi gjinore |
| 1.3. | Aktivitete vetdijesuese për publikun e gjerë mbi të drejtat e tyre qasje në shërbime dhe mbrojtjen nga diskriminimi gjinor dhe i shumëfisht | 2026-2028 | 500 | 500 | 500 | Buxheti Komunal | **Drejtoria E administrates DKA DSHMS** Sektori për Drejtat e Njeriut Barazi Gjinore. | 1 deri 2 aktivitete vetdijesuese ne vit. 20 deri 30 pjesmarrese në vit të ndarë sipas gjinisë dhe moshes. | Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë PKBGJ |
| 1.4. | Fushata vetëdijesuese ,informuese kundër trafikimit të qenjeve njerzore .18 Tetor – 18 Nëntor. | 2026-2028 | 1000 | 1000 | 1000 | Nuk ka kosto shtesë | **Drejtoria e Arsimit , Shkollat QPS-të Policia** | Aktivitete e realizuar gjatë fushtaes se paku nje fushatë në vit. | PKBGJ |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | Sektori për Drejtate Njeriut Barazi Gjinore | | |
| 1.5. | Fushatë vetëdijesuese kundër dhunës në bazë gjinore, 16 Ditëve të Aktivizmit kundër dhunës në bazë gjinore. | 2026-2028 | 3000 | 3000 | 3000 | Buxheti Komunal / Donatoret | Drejtorit komunale.<br>Sektori për të Drejtate e Njeriut Barazi Gjinore<br>Mekanizmi lokal kuder Dhunes në familje.<br>QPS.<br>Policia e Kosovës.<br>OJQ | Numri i aktiviteteve vetëdijësuese të realizuara çdo vit në kuadër të fushatës së 16 Ditëve të aktivizmit. | PKBGJ, LBGJ |
| 1.6. | Zhvillimi i aktiviteteve informueses dhe vetëdijesueses me të rinjtë dhe të rejat, si dhe me gratë dhe burrat,lidhur me | 2026-2028 | 3000 | 3.000 | 3000 | Buxheti komunal dhe donatoret | DKA<br>Sektori për të Drejtate e Njeriut Barazi Gjinore | Numri i pjesëmarrëseve/ pjesëmarrësve, ndarë sipas gjinisë, moshës, etj. (Në secilën nga shkollat marrin pjesë | PKBGJ, LBGJ |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | parandalimin e dhunës në bazë gjinore dhe dhunës në familje përfshirë informimin mbi mekanizmat ekzistues dhe shërbimet mbrojtëse për viktimat e këtyre formave të dhunës. | | | | | | Mekanizmi lokal kuder Dhunes në familje.<br>QPS.<br>Policia e<br>Kosovës.<br>OJQ | rreth 50-60 nxënës/e) | |
| 1.7. | Aktivitete informuese ,vetëdijesuese me prindërit për parandalimin e martesave të hershme të fëmijëve vajza dhe djem si dhe për pasojat sociale,shëndetësore dhe ligjore të tyre. | 2026-2028 | 1000 | 1000 | 1000 | | Zyrtaret komunal per hartimin e politikave dhe<br>ZBGJ<br>ZKK<br>Shkollat | 1 – 2 fushata në vit. | LBGJ |
| 1.8. | Trajnime për lidership dhe vendimarrje për gra dhe të reja. | 2026-2028 | 1000 € | 15000€ | 15000 € | | Zyra e personelit<br>Drejtoria e Administrates<br>Sektori për të Drejatat e Njeriut Barazi Gjinore. | Së paku 1 der 2 trajnime për vit. | PKBGJ |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | GGA | | |
| 1.9 | Miratimi i masave të veçanta(afirmative) që sigurojnë barazi gjinore në praktikë, në pozitat vendimmarrëse të ekzekutivit komunal për shtimin e zyrtareve gra të reja në të gjitha drejtoritë komunale sipas nevojës | 2026 -2028 | | | | | KK<br>Sektori për të Drejatat e Njeriut Barazi Gjinore<br>GGA | Numri i masave të veçanta (afirmative ) të miratuara | LBGJ |
| 1.10 | Zbatimi i masave afirmative për promovimin e barazisë gjinore në emërtimin e objekteve publike,rrugëve dhe shesheve,duke siguruar përfaqësim të barabartë dhe evidentim të figurave të shquara të grave dhe vajzave,në përputhje me barazinë gjinore. | 2026 - 2028 | | | | | Komisioni për emrimin e rrugëve.<br>Sektori për të Drejtate Njeriut Barazi Gjinore | Numri i rrugëve të emruara . | LBGJ |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.11 | Lirimi nga pagesa e legalizimit të pronave kur gruaja është pronare ose bashkëpronare, me qëllim rritjen e sigurisë juridike dhe fuqizimin ekonomik të grave. | 2026- 2028 | | | | | Drejtoria për Planifikim Urban<br>Zyra e Kryetarit<br>Zyra Ligjore | Numri i pronave te legalizuara çdo vit. | LBGJ |
| 1.12 | Mbledhja e të dhënave për përgatitjen e raportit dhe publikimi i gjetjeve nga monitorimi i përvitshëm i zbatimit të këtij Plani lokal të veprimit për barazinë gjinore (PLVBGJ) | 2026 -2028 | 100 | 100 | 100 | Buxheti komunal | Të gjitha drejtoritë<br>ZKDNJ | Gjetjet e publikuara në mënyrë të përvitshme, bazuar në raportin e plotë të monitorimit të zbatimit të PLVBGJ | |
| | *Objektivi Specifik* | *1.2 Zbatimi në praktikë i integrimit gjinor dhe buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, si mjete për përparimin e Komunës drejt barazisë gjinore.* | | | | | | | |

| Veprimi/Aktiviteti | Afati i fundit | Buxheti | | | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Produkti rezultati | Referenca në dokumente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Viti 2026 | Viti 2027 | Viti 2028 | | | | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.2.1. Fuqizimi i kapaciteteve të zyrtareve/zyrtarëve të drejtorive komunale për integrimin gjinor, vlerësimin e ndikimit gjinor dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor. | 2026-2028 | 1500 | 1500 | 2000 | Buxheti Komunal | ABGJ Drejtoria e Administrates. Sektori për të Drejtat e Njeriut Barazi Gjinore | 2 trajnime në vit 60 përsona të përfshirë 20 të ndar në vit. | |
| 1.2.2. Zbatimi i buxhetimit të përgjegjshem gjinor (BPGJ)nga të gjitha drejtoritë komunale dhe publikimi i aneksit mbi Buxhetimin Gjinore në mënyrë të rregullt vjetore. | 2026 -2028 | 500 | 500 | 1000 | Buxheti komunal, donatoret | Drejtoritë komunale, Drejtoria e financave ,OJQ | Numri i programeve buxhetore ku aplikohet BPGJ | PKBGJ dhe Ligji per barazi gjinore |
| 1.2.3Takime informuese me gra,të reja vajza nga grupe të ndryshme,mbi rëndësinë e pjesëmarrjes në vendimmarrje publike veçanerisht në dëgjimet buxhetore. | 2026-2028 | 2000 | 2000 | 2000 | Buxheti Komunal | Të gjitha drejtoritë komunale, Zyra për Komunitete. Sektori për të Drejtate Njeriut Barazi Gjinore , Grupi i grave Asamblesiste. | 1 deri 2 aktivitete vetdijesuese ne vit. 20 deri 30 pjesmarrese në vit të ndarë sipas gjinisë dhe moshes. | Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë PKBGJ |
| 1.2.4 Përgatitja e formave të unifikuara | 2026 -2028 | 800€ | - | - | Buxheti Komunal | Të gjitha drejtoritë | Format e përgatitura dhe të | LBGJ |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| për mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe karakteristikave të tjera, për të gjitha aktivitetet që organizon komuna | | | | | Donatoret | Zyra e Kryetarit Sektori për të Drejtat e Njeriut Barazi Gjinore. | shpërndara në të gjitha drejtoritë e komunës | |

| 2 | Objektivi Strategjik: PROMOVIMI I TË DREJTAVE EKONOMIKE,SOCIALE DHE TË PUNËSIMIT TË DENJË,SI DHE FUQIZIMIT TË VAJZAVE TË REJA DHE GRAVE. | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.1 | Objektivi specifik: Rritja e qasjes së grave dhe vajzave ,në të gjithë rrethanat e tyre ,në sherbime dhe produkte financiare si dhe në burime produktive, me fokus në zhvillimin ekonomik të zonave rurale dhe promovimin e ekonomisë mjedisore. | | | | | | | | |
| | Veprimi/Aktiviteti | Afati i fundit | Buxheti | | | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Produkti rezultati | Referenca në dokumente |
| | | | Viti 2026 | Viti 2027 | Viti 2028 | | | | |
| 2.1 | Plotësim – ndryshimi i rregullores për ndarjen e granteve dhe subvencioneve ku të vendosen masa afirmative që u japin përparësi dhe nxitin mbështetjen e grave | 2026-2028 | | | | Buxheti Komunal | Zyra Ligjore Të gjitha drejtoritë komunale që ndajnë grante e subvencione | Rregullorja e plotësuar ,ndryshuar dhe miratuar | Ligji per barazi gjinore |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | fermere e në ndërmarrësi | | | | | | | | |
| 2.2 | Informimi i grave në sektorin e bujqësisë mbi subvencionimin nga komuna, grantet dhe subvencionet nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, etj. | 2026 -2028 | 500 | 500 | 500 | Buxheti komunal, donatoret | Drejtoria e Bujqësisë zhvillim rural. Drejtoria e zhvillimit ekonomik Sektori për të Drejtat e Njeriut Barazi Gjinore OJQ | 6 takime inxformuese (2 në vit). - 60 gra të informuara (20 në vit) ndarë sipas moshës, etnisë, vendbanimit. | PKBGJ dhe Ligji per barazi gjinore |
| 2.3. | Mbështetja e grave me start up. | 2026-2028 | 9000 | 9000 | 10.000 | Buxheti Komunal Donatoret | Drejtoria për zhvillim ekonomik Donatorë | -9 gra të mbështetura (3 në vit) . | LBGJ PKBGJ |
| 2.4 | Ofrimi i mundësive për promovimit dhe shitjen e produkteve bujqësore, me fokus mbështetjen e grave e të rejave fermere, përmes organizimit të tregut mobil të fermereve - fermerëve. | 2026-2028 | 1000 | 2000 | 3000 | Buxheti Komunal Donatoret | Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Bujqësisë zhvillim rural. | Numri i grave dhe të rejave fermere që marrin pjesë në Tregun mobil.<br><br>Numri i shesheve që përdoren për tregun mobil | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.5 | Promovimi dhe shitja e produkteve të prodhuara nga gratë të rejat fermere e në ndërmarrësi, duke synuar përfshirjen e tyre në panaire të ndryshme lokale | 2026-2028 | 1000 | 2000 | 2000 | | DBPZHR<br><br>Drejtoria e zhvillimit ekonomik | 2 panaire të organizuara (1 në vit) . – 15 gra të subvencionuara në panairet lokale në vit. | |
| | Fushata vetëdijesues për të drejtat pronësore dhe trashëgimin e pronës për gratë. | 2026 – 2028 | 2000 | 2000 | 2000 | | Drejtoria e Kadastrit . Sektori për Drejtat e Njeriut Barazi Gjinore. | 1 deri 2 aktivitete vetdijesuese ne vit.<br>20 deri 30 pjesmarrese në vit të ndarë sipas gjinisë dhe moshes. | LBGJ |
| | Promovimi i Udhëzimit Administrativ për regjistrimin e pronës së palujtshme të përbashkët në emer të dy bashkëshortëve | 2026 - 2028 | 500 | 500 | 500 | | Drejtoria e Kadastrit . Sektori për Drejtat e Njeriut Barazi Gjinore. | 1 fushte në vit, materjale promovuese. | |

| 2<br>2.1 | Objektivi specific: *Rritja e qasjes së grave, burrave, të rejave, të rinjve, vajzave e djemve. në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime sociale cilësore, gjithëpërfshirëse e të përgjegjshme gjinore.* | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Veprimi/Aktiviteti | Afati i fundit | Buxheti<br>Viti 2026 | Viti 2027 | Viti 2028 | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Produkti rezultati | Referenca në dokumente |
| 2.1 | Integrimi i perspektivës gjinore në ndarjen e subvencioneve për familjet në asistencë sociale (nënar vetushqyese, familjet me një anëtar/e, personat me aftësi të kufizuara, personat që kanë pësuar dhunë, etj.) | 2026-2028 | | | | Buxheti Komunal | Drejtoria e Financës.<br>Qendra për Punë Sociale.<br>Zyra e Kryetarit.<br>Kuvendi Komunal | Numri i përfitueseve/përfituesve, ndarë sipas gjinisë, moshës dhe klasifikimit të familjeve në | Ligji per barazi gjinore |
| 2.2 | Ofrimi i strehimit social për viktimat/të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje dhe grave kryefamiljare me gjendje të vështirë ekonomike. | 2026 - 2028 | 1000 | 1500 | 1500 | Buxheti komunal, donatoret | Zyra e Kryetarit.<br>DSHMS<br>OJQ "Qendra për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve".<br>GGA | Numri i viktimave/të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje të strehuara, ndarë sipas moshës, seksit, e karakteristikave të tjera. | PKBGJ dhe Ligji per barazi gjinore |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.3. | Subvencione për përmirësimin e cilësisë dhe përgjegjshmërisë gjinore të shërbimeve sociale e familjare, përmes nën kontraktimit të OJQ-ve të specializuara. | 2026-2028 | 3000 | 5000 | 5000 | Buxheti Komunal Donatoret | Drejtoria e Financës.<br>DSHMS<br>Qendra për Punë Sociale.<br>Zyra e Kryetarit.<br>Kuvendi Komunal | Numri i OJQ-ve të licencuara, të kontraktuara për ofrimin e shërbimeve sociale cilësore e të përgjegjshme gjinore. | LBGJ PKBGJ |
| 2.4 | Subvencionimi i pagesës për parashkollor për fëmijet të nënave vetëushqyeses. | 2026-2028 | 1000 | 2000 | 3000 | Buxheti Komunal Donatoret | DKA DSHMS | Numri i fëmijëve të subvencionuar të ndarë sipas gjinisë dhe moshes. | |
| 2 | Objektivi Strategjik ZVOGËLIMI I PABARAZIVE GJINORE NË ARSIM CILËSOR, KULTURË E SPORT, PËR GRATË, BURRAT, TË REJAT, TË RINJTË, VAJZAT DHE DJEMTË, NË TË GJITHA RRETHANAT. | | | | | | | | |
| 2.1 | Objektivi specifik: *Ofrimi i mundësive të barabarta për arsim cilësor e të mësuarit gjatë gjithë jetës,për vajzat të rejat dhe gratë si dhe djemtë,të rinjtë e burrat në të gjitha rrethanat e ndryshme .* | | | | | | | | |
| | Veprimi/Aktiviteti | Afati i fundit | Buxheti Viti 2026 | Buxheti Viti 2027 | Buxheti Viti 2028 | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Produkti rezultati | Referenca në dokumente |
| 2.1 | Organizimi i fushatave takimeve informuese , nxënëset dhe nxënësit mund të informohen rreth profileve që mund të përcaktohen. duke synuar edhe thyerjen e | 2026-2028 | 500 | 500 | 500 | Buxheti Komunal | DKA<br>Shkollat<br>Sektori për të Drejtat e Njeriut<br>Barazi Gjinore. | Fushata e zhvilluar sipas planifikimit.<br>Numri i nxënëseve,nxënësve të përfshirë ndarë sipas gjinisë, moshës dhe karakteristikave grupi i synuar klasat e nënta . | Ligji per barazi gjinore |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | steriotipeve gjinore në punësim. | | | | | | | | |
| | Monitorimi i mënyrës së plotësimit të këshillave drejtuese të shkollave dhe punës së tyre, duke respektuar parimet e barazisë gjinore (BGJ) | 2026 – 2028 | | | | | DKA<br>Shkollat<br>Sektori për të Drejtat e Njeriut<br>Barazi Gjinore | Numri i këshillave drejtuese të shkollave, të plotësuar sipas parimeve të BGJ | LBGJ |
| 2.2 | Aktivitete vetdijesuese për shenimin e ditës ndërkombëtare të vajzave.<br>11 tetori, Dita Ndërkombëtare e vajzave. | 2026 - 2028 | 500 | 500 | 500 | Buxheti komunal, donatoret | DKA<br>Shkollat<br>Sektori për të Drejtat e Njeriut<br>Barazi Gjinore. | Numri i nxënëseve,nxënësve të përfshirë,ndarë sipas gjinisë | PKBGJ dhe Ligji per barazi gjinore |
| 2.3. | Ndarja e bursave komunale për studentet dhe studentët e komunes tonë. | 2026-2028 | 300,700€ | 358,024€ | 490,000€ | Buxheti Komunal i paraparë për mbështetje studentëve/ eve subvencione në kuader të Drejtorisë së arsimit | Drejtoria e Financave.<br>DKA<br>ZK | Numri i bursave të ndara çdo vit, sipas gjinisë, moshës, degës së zgjedhur, etj. | LBGJ<br>PKBGJ<br>Rregullorj a komunale për ndarje të subvencioneve. |
| 2.4 | Fuqizimi i kapaciteteve të mësimdhënëseve , mësimdhënësve në fushën e barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut. | 2026-2028 | 1000 | 2000 | 3000 | Buxheti Komunal Donatoret | DKA | 60 mësimdhënës/e të trajnuar/a (30 në vit), ndarë sipas seksit, profilit, | LBGJ |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Sesione informuese për tematika të lidhura me bulizmin, diskriminimin gjinor dhe disavantazhimin e shumëfishtë | 2026-2028 | 1000 | 1000 | 1000 | Komuna Donatoret | DKA OJQ | 2 sesione (1 në vit) - duke specifikuar edhe pjesëmarrjen e nxënëseve, nxënësve | LBGJ LKD |
| | Vlerësimi pedagogjik i nxënëseve,nxënësve me nevoja të veçanta nga Ekipi komunal pedagogjik përkatës | 2026 - 2028 | 3000 | 3000 | 4000 | | Ekipi Komunal Pedagogjik DKA DSHMS | 20 nxënës/e të vlerësuar/a për vitin 2026 Numri ndryshon në varësi të kërkesës. | |
| | Subvencionimi i fëmijëve (vajza e djem) në kopshtet me bazë në komunitet dhe partneritetin publik – privat (PPP), si mundësi për lehtësimin e qasjes së nënave në tregun e punës. | 2026-2028 | 3000 | 4000 | 5000 | Komuna | Drejtoria e Financave. DKA ZK Kuvendi komunal. | Numri i fëmijëve të subvencionuar | LBGJ |
| | Trajnimi dhe aftesimi i grave në Teknologjin e Informacionit dhe Komunikimit. | 2026 - 2028 | 1000 | 2000 | 2000 | Komuna Donatoret | Shkollat e Mesme profesionale. Kshilltarë të karrieres. | 3 kurse tre mujore - një në vit 20 gra,vajza të aftësuara 10 në çdo kurs të ndara sipas moshës,etnisë. | LBGJ PKBGJ |
| 2<br>2.1 | Objektivi specific: *Promovimi i modeleve të suksesshme të grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë rrethanat e tyre, që investojnë dhe marrin pjesë aktivisht në kulturë dhe sport.* | | | | | | | | |
| | Veprimi/Aktiviteti | Afati i fundit | Buxheti<br>Viti 2026 | Viti 2027 | Viti 2028 | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Produkti rezultati | Referenca në dokumente |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.1 | Integrimi i perspektives gjinore në planifikimin dhe organizimin e ngjarjeve kulturore dhe artistike,duke promovuar përfaqësim të barabartë dhe përmbajtje gjithëpërfshirëse,si dhe parandalimin e stereotipeve gjinore në projektet dhe aktivitetet në fushën e kulturës dhe artit. | 2026-2028 | | | | Buxheti Komunal | Drejtoria e Financës. Drejtoria e Kulturës.DK ZK OJQ. Biznese private. | 10 deri 20 vajza, të reja dhe gra përfitojnë subvencion në kulturë | Ligji per barazi gjinore |
| 2.2 | Mbështetje vjetore e aktiviteteve të klubeve sportive dhe OJQ rinore. | 2026 - 2028 | | | | Buxheti komunal, donatoret | Drejtoria e Financave ZK Klubet Sportive. | 2deri 5 projekte të OJQ të drejtuara nga gratë. 60 - 120 përfituese, përfitues në vit. | PKBGJ dhe Ligji per barazi gjinore |
| 2.3. | Sigurimi i zhveshtoreve për vajzat në të gjitha ambientet sportive | 2026-2028 | 10,000 | 15,000 | 15,000 | Buxheti Komunal Donatoret | DF Drejtoria e Kulturës.DK Klubet Sportive | Një zhveshtore, tri tribuna | LBGJ PKBGJ |
| | Subvencionimi i klubeve të vajzave dhe avokimi në mënyrë të vazhdueshme për mbështetjen e këtyre klubeve | 2026 - 2028 | 400,000€ | 400,000€ | 300,000€ | Buxheti Komunal i planifikuar në subvencione në kuader të Drejtorisë ku një pjesë e paraparë për klubet. | Drejtoria e Kultures. Klubet sportive OJQ | Klubet e vajzave të subvencionuara | LBGJ Rregullor e MF- NR-04/2017. |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | |
| 2 | Objektivi Strategjik: . AVANCIMI I BARAZISË GJINORE PËRMES NJË QASJEJE GJITHËPËRFSHIRËSE NË PROMOVIMIN E KUJDESIT DHE EDUKIMIT SHËNDETËSOR. | | | | | | | | |
| 2.1 | Objektivi specifik: *Rritja e qasjes së barabartë në shërbime shëndetësore cilësore.* | | | | | | | | |
| | Veprimi/Aktiviteti | Afati i fundit | Buxheti Viti 2026 | Buxheti Viti 2027 | Buxheti Viti 2028 | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës dhe mbështetës | Produkti rezultati | Referenca në dokumente |
| 2.1 | Takime koordinuese me personelin shëndetësor dhe Drejtorinë e Shëndetësisë për organizimin e aktiviteteve vetëdijesuese në shkollat | 2026-2028 | | | | Buxheti Komunal | DSHMS<br>QKMF<br>Anëtarë nga MKKDHF.<br>Drejtoria e Arsimit.<br>Shkollat. | 2 – takime te organizuara në vit. | Ligji per barazi gjinore |
| 2.2 | Organizimi (përmes ekipeve mobile) i vizitave të rregullta në familje për nënat lehona dhe foshnjat e tyre, sidomos në zonat rurale | 2026 - 2028 | 500 | 500 | 500 | Buxheti komunal, donatoret | DSHMS<br>QKMF | 300 vizita të organizuara në vit<br>Numri i lehonave dhe fëmijëve të vizituar | PKBGJ dhe Ligji per barazi gjinore |
| | Takime informuese me gratë, të rejat, vajzat dhe burrat, të rinjtë, djemtë, mbi të drejtat e tyre dhe kujdesin për shëndetin. | 2026 - 2028 | 1000 | 1000 | 1000 | | | 10 takime të realizuara në vit<br>- 400 persona të përfshirë në vit, ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, etj. | LBGJ |
| | Fushatë vetdijesuese kundër Kancerit të gjirit. | 2026 - 2028 | 1000 | 1000 | 1000 | Buxheti komunal/donatoret | QKMF<br>DSHMS | Aktivitete e realizuara,takimet informuese . | LBGJ |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Shënimi i Tetorit Rozë. çdo vit. | | | | | | | Fushata gjatë vitit. | |
| | Ndarja e subvencioneve, mbështetjes për gratë e prekura dhe të mbijetuara nga kanceri i gjirit | 2026 – 2028 | 500,000 | 500,000 | 400,000 | Buxheti Komunal i planifikuar në kuader të Drejtorisë për subvencione ku një pjesë është paraparë për të prekurit/at me kancer. | DSHMS QKMF | Numri i grave përfituese sipas kërkesave | LBGJ Rregullor e MF- NR-04/2017 |
| | Mbështetje psikologjike,moral për të prekurat nga kanceri i gjirit përmes takimeve ,debateve. | 2026 - 2028 | 1000 | 1000 | 1000 | Buxheti komunal/ Donatoret | DSHMS QKMF Sektori për Drejatat e Njeriut Barazi Gjinore. | I takim ne vit<br>Përfitues rreth 10 – 15 gra. | |

**Vjosa Ahmetaj**

**From:** Luljeta Ibishi
**Sent:** Thursday, April 16, 2026 8:31 AM
**To:** Vjosa Ahmetaj
**Cc:** Lendrit Iljazi; Xhevat Tafa
**Subject:** RE: Për vlerësim....

**Follow Up Flag:** Follow up
**Flag Status:** Flagged

E nderuara Vjosa,

Sa i përket vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit, ju njoftojmë se i njëjti është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nuk paraqet pengesa nga aspekti juridik.

Në këtë drejtim, mund të vazhdoni me procedurat e mëtejshme sipas kompetencave tuaja.

Me respekt,
Lulja

---

**From:** Vjosa Ahmetaj <Vjosa.Ahmetaj@rks-gov.net>
**Sent:** Wednesday, April 15, 2026 3:31 PM
**To:** Luljeta Ibishi <Luljeta.Ibishi@rks-gov.net>
**Cc:** Xhevat Tafa <Xhevat.Tafa@rks-gov.net>
**Subject:** Për vlerësim....

E nderuara,

Bashkangjitur gjeni Vendimin Nr.113 për aprovimin në parim për diskutim publik të Projekt Planit të Veprimit për barazi gjinore për vitet 2026-2028 në Komunën e Fushë Kosovës, i miratuar në Kuvendin e Komunës së Fushë Kosovës me datë 18.03.2026, për vlerësim të ligjshmërisë.

Me respekt,
Vjosa Ahmetaj